

**GMIP/KDS për “Reformën në Drejtësi”
Raport Gjashtëmujor i Progresit për periudhën janar-qershor 2020**

Hyrje

Në zbatim të Urdhrit nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar” në muajit *shtator 2020* u zhvillua mbledhja e Komitetit Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi/Mekanizmi Institucional të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, me qëllim prezantimin e draftit të Raportit të Monitorimit për periudhën janar – qershor 2020 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, si dhe njohja me komponentin nr. “Aksesi në drejtësi” të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (OGP). Përsa i përket strukturës së Raportit, çështjet kryesore të përfshira, konsistojnë në: aktivitetet e realizuara gjatë periudhës në fjalë, përmbledhja ekzekutive mbi reformën e sistemit të drejtësisë, arritjet kryesore në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, konkluzionet dhe sfidat etj.

Takimi i KDS/Mekanizmit Institucional është zhvilluar më datën 29 shtator 2020, nëpërmjet platformës online WebEX Cisco.

Takimi u hap nga znj. Adea Pirdeni, zëvendësministër i Drejtësisë. Në fjalën e saj znj. Pirdeni përshëndeti anëtarët e Mekanizmit Institucional/Komitetit Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi, si dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë, të pranishëm në takimin online. Znj. Pirdeni në fjalën e saj hyrëse, vlerësoi pjesëmarrësit për rolin e tyre gjithëpërfshirës në këtë proces, bashkëpunimin e tyre në dërgimin e kontributeve lidhur me zbatimin masave të Planit të veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Gjithashtu, në emër të Ministres së Drejtësisë, znj. Pirdeni falenderoi dhe përfaqësuesit e institucioneve të pavarura, për rolin e tyre në këtë proces të rëndësishëm.

Në fjalën e saj, znj. Pirdeni theksoi se Reforma në Drejtësi është aktualisht në një fazë shumë të rëndësishme të zbatimit të saj dhe është një ndër prioritetet kryesore për të cilën të gjitha institucionet që operojnë në sistemin e drejtësisë duhet të angazhohen maksimalisht.

Më tej, ajo informoi se hapësirën kohore në vijim do t’i dedikohej arritjeve të gjashtë mujorit të parë të zbatimit të SND. Monitorimi i vazhdueshëm i angazhimeve të marra përsipër mbetet prioritet kryesor. Kështu krahas ndërhyrjeve legjislative, reforma në drejtësi shoqërohet me dokumenta strategjikë.

Strategjia është në përputhje me rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Europian.

Më tej ajo u shpreh se implementimi i masave të Strategjisë ecën në mënyrë paralele me funksionimin e Shqipërisë si një vend me parime europiane.

Kësisoj, SND është hartuar dhe rishikuar në përputhje me pesë prioritetet kryesisht prioriteti 2, 3 dhe 5 ku Ministria është institucion kontribues.

Zëvendësministria Pirdeni, theksoni se natyrisht nuk mund të anashkalohet fakti se reforma në drejtësi kërkon një monitorim të kujdesshëm që do integritet e profesionalizëm.

Në vijim ajo prezantoi përpara Mekanizmit të monitorimit sikundër është konstatuar edhe prej raportit gjashtë mujor arritjet kryesore të arritura ku përmbodhi: *“funksionimin e plotë të KLGJ dhe KLP me kapacitete të plota dhe process që vazhdon. Natyrisht që gjatë këtij viti është konstatuar edhe realizimi i plotë i KED për plotësimin e vakancave të GJK. KLGJ ka pasur masa konkrete për miratimin e një plani për reduktimin e çështjeve të mbetura. Që prej masrit 2020 gjl përbëhet nga tre anëtarë të rinj të cilët kanë shqyrtuar 866 çështje në total. Ka patur progress edhe në lidhje me programin e rekrutimit në SHM dhe nr e kandidatëve që do pranohen në vijim. Një nga zhvillimet më të rëndësishme janë zhvillimet në kuadër të sistemit të ndihmës juridike, ku MD ka ushtruar plotësisht kompetencat e saj ku janë ngritur pesë qendra dhe pritet hapja e qendrave të tjera në total 10, të cilat od të ofrojnë ndihmë juridike parësore. Natyrisht që ky process ecën paralelisht me miratimin e 12 organiztave, të shoqërisë civile që do të ofrojnë ndihmë juridike. Në lidhje më zhvillimet përsa përket objektivave në fushën e drejtësisë penale ka një numër në rritje të dënuarve që përshihen në aktivitete rehabilituese, aktivitete që janë ndërprerë prej pandemisë. Gjithashtu vërehet se ka një ulje të mbipopullimit në burgje. Është krijuar edhe vënë në funksionim sistemi NISA një system elektronik që lidh në kohë reale punën e noterit me institucionet.”*

Në vijim të fjalës së saj, zv. Ministria informoi se ka ende dhe një sërë masash në process që do duan edhe pak kohë, ku përmendim miratimin e hartës gjyqësore. Duhet theksuar se këto masa në proces janë kushtëzuar nga dy fatkeqësi natyrore që kanë prekur vendin tërmeti dhe pandemia.

MD e vlerëson si jetik ecurinë e reformës në drejtë dhe zbatimin e SND-së duke dhënë kontributin e saj në funksionimin e institucioneve të reja të drejtësisë.

Në përfundim të fjalës së saj ajo theksoi se ky process monitorimi nuk do ishte i mundur pa bashkëpunimin e institucioneve të paravurura kushtetuese dhe syrit vëzhgues të shoqërisë civile. Falenderime të vecanta i rezervohen per kontributin e tyre per reformimin e një sistemi drejtësie të shëndetshëm në drejtësi.

Në përfundim të fjalës së saj, znj. Pirdeni theksoi se, Ministri i Drejtësisë, nuk ka reshtur dhe nuk do te reshtë së kontribuari dhe mbështetur funksionalitetin e organeve të reja në bazë të kompetencave që i ngarkon kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi, duke ruajtur ndarjen e pushteteve. Por duke qenë një reformë gjithëpërfshirëse, duhet nga të gjithë transparencë, efektshmëri, koordinim dhe bashkëpunim institucional si dhe llogaridhënie me qëllim, bërjen të mundur realizimin e saj duke iu përgjigjur, pritshmërive të qytetarve për këtë reformë.

Për informacion më të detajuar shërben tabela më poshtë:

Mbledhjet e GMIP/KDS dhe te GT	Data e mbledhjes	Data e planifikuar ne kalendarin e miratuar nga SP.	Tematikat e shqyrtuara	Evidencat e secilës mbledhje (psh. Agenda, Listë pjesemarrja, Minuta, dokumente për shqyrtim, konkluzione)
Mbledhja 2	29/09/2020	Shtator 2020	<ol style="list-style-type: none"> 1. Prezantimi i draftit të Raportit të Monitorimit për janar – qershor 2020 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. 2. Aktivitetet e realizuara për periudhën gjashtëmujore. 3. Rezultatet dhe sfidat në fushën e drejtësisë. 4. Njohja me komponentin nr.3 “Aksesi në drejtësi”. 5. Politika kryesore e komponentin nr.3. 6. Objektivat specifik të komponentit nr.3 	

Objektivat e GMIP në 2020

Më pas, fjalën e mori znj. Elona Hoxha, e cila njohu pjesëmarrësit me rezultatet e Raportit gjashtë mujor të Monitorimit për periudhën janar-qershor 2020.

Në fjalën e saj znj. Hoxha nënvizoi se dokumenti është raporti i dytë i vitit 2020 për monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planit të saj të Veprimit, i cili mbulon periudhën nga 1 janar 2020 deri në 30 qershor 2020. Qëllimi është që të kemi informacion mbi arritjet e progresit dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë.

Znj. Hoxha, informoi se raporti i monitorimit është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit 2019 - 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe në përputhje me procedurat/standartet në zbatim të VKM-së Nr. 290, datë 11.04.2020 “Per krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)”. Pjesëmarrësit u informuan, nga znj. Hoxha, se për periudhën janar – qershor 2020 nga 65 masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2019 – 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë realizuar 18 prej tyre, 41 prej tyre janë ende në proces zbatimi, dhe 6 masa janë të përcaktuara. Përqindja ndaj totalit të progresit të

zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 është në nivelin 28% për masat të cilat janë të realizuara, 63% për masat në proces, si dhe 9% për masat të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Më pas fjalën e morri znj.Frashëri, e cila njohu të pranishmit me komponentin nr.3 “Aksesi në drejtësi” të OGP. Në fjalën e saj, ajo u ndal te lidhja e këtij komponenti me komponentët e tjerë të OGP dhe rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile.

Znj.Frashëri theksoi se OGP synon të :

Siguron aksesin e qytetarëve në vendimmarrjet e institucioneve shtetërore nëpërmjet pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike; Nxiti transparencën qeveritare në ndarjen e informacionit dhe procesin e vendimmarrjes; Ndihmon për të luftuar fenomenin e korrupsionit në të gjitha nivelet e ekspozimit të tij; Kontribuon në një qeveri llogaridhënëse; Kontribuon në sundimin e ligjit dhe krijimin e një shoqërie demokratike.

Më pas. Znj.Frashëri bëri një prezantim të politikës kryesore e komponentit 3 dhe të objektivave specifik të tij. Në vijim, prezantimi vazhdoi me spjegimin e metodologjisë së ndjekur për këtë proces dhe me në detaje u shpejgua se procesi i ndërmarrë nga DPSFD ka kaluar këto faza: Përcaktimin e listës së shoqërisë civile, akademisë dhe profesionistëve juristë (“grupeve të interesit”); Draftimin e Planit të Veprimit të Komponentit të Aksesit në Drejtësi (përfshirë politikën kryesore, objektivat specifike, masat/aktivitetet në përmbushje të këtyre objektivave); Përgatitjen e pyetësorit/sondazhit i cili u konsultua me ekspertin e angazhuar nga DZHM pranë Kryeministrit; Dërgimin e informacionit nëpërmjet emailit te grupet e interesit; Drafti i Planit të Veprimit dhe pyetësori gjenden në këtë link: <http://ogp.gov.al/artikull/komponenti-3-drejtjesi>. Në përfundim, znj.Frashëri theksoi se puna do të vijoj më konsultime me grupet e interesit brenda muajit Tetor, si dhe do të ketë koordinim me institucionet përgjegjëse për masat në kuadër të finalizimit të Planit të Veprimit duke marrë parasysh mendimet e grupeve të interesit gjatë fazës së konsultimeve.

Më pas fjalën e morri ekspertja e OGP, znj. Courtney McLaren. Në vija të përgjithshme ajo shprehu mirënjohje dhe falenderim në lidhje me bashkëpunimin dhe punën e realizuar në procesin e OGP deri më sot dhe në veçanti për raportin paraprak të konsultimit. Konsultimit të realizuar ditën e sotme i kushtoi rëndësi, ftoi grupet e interesuara për diskutim me qëllimin e mbështetjes së ideve, sugjerimeve të reja apo problematikave që kanë hasur gjatë këtij procesi.U tregua e hapur ndaj cdo pyetje,paqartësie dhe problematike te hasur.

Mbledhjet e GMIP/KDS	Rekomandimet e mbledhjes	Ndjekja e rekomandimeve
----------------------	--------------------------	-------------------------

<p>Dt. 29/09/2020</p> <p>Rekomandim 1 – Dakortësimi me anëtarët e KDS/Mekanizmit Institucional lidhur me miratimin e draft-Raportit Gjashtëmuor të Monitorimit, për periudhën janar – qershor 2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.</p> <p>Rekomandim 2 – Rritja e përgjegjshmërisë së institucioneve për të raportuar në kohë dhe me cilësi lidhur me informacionin mbi masat e Planit të Veprimit.</p> <p>Rekomandim 3 – Dërgimi i informacionit mbi kostot/shpenzimet të çdo institucioni lidhur me masat e parashikuara në Planin e Veprimit 2019-2021.</p> <p>Rekomandimi 4 – Përfshirja e Shoqërisë Civile gjatë hartimit të planit të veprimit në zbatim të komponentit nr.3 të OGP.</p>		<ol style="list-style-type: none"> 1. Sekretariati Teknik, në mbështetje të procesit të monitorimit dërgoi dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese, shoqërisë civile, si dhe publikoi draftin në faqen zyrtare të MD-së. 2. Me Vendimin Nr.261, datë 30.09.2020 u miratua Raporti Gjashtëmuor i Monitorimit për periudhën Janar-Qershor 2020 (bashkëlidhur Vendimi) 3. Në raportin e ardhshëm të monitorimit nevojitet një bashkëpunim më i lartë i institucioneve, për të kontribuar dhe raportuar lidhur me implementimin e Planit të Veprimit 2019 - 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. 4. Mosdërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar për aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit 2019-2021, ndikon në pasqyrimin jo real të kostove për zbatimin e Strategjisë. Për këtë arsye, në raportet e ardhshme të monitorimit nevojitet të raportohet nga institucionet në lidhje me buxhetin e shpenzuar për realizimin e masave/aktiviteteve të mbuluara nga buxheti i shtetit, si dhe donatorët. 5. Rritjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe universitetet në këtë project.
--	--	---

Sfida

Më pas, duke iu referuar edhe agendës, Znj. Pirdeni ia kaloi fjalën pjesëmarrësve, për diskutime. Znj. Evis Qaja, Drejtor në Drejtorinë e Politikave dhe Sistemit të Mirëqeverisjes në Kryeministri falenderoi në fjalën e saj të gjithë kolegët e Ministrisë që kanë punuar fort për të realizuar një raport si dhe të gjithë kolegët pjesëmarrës. Ajo theksoi se zyra e KM në kuadër të detyrimeve që ka për të përmbushur sistemin e integruar të menaxhimit IPSIS, shpreh vlerësime maksimale për raportin e monitorimit gjashtë mujor. Ajo nënvizoi se është bërë një punë e madhe për sjelljen e këtij raporti në përputhje me sistemin IPSIS. Në këtë aspekt ajo në emër të departamentit shpreh vlerësimin maksimal. Ajo përfundoi duke theksuar se ky raport garantonte përfaqshen drejt performancës por garanton edhe tentativën për të bërë përputhshmërinë në lidhje me analizën financiare. Dhe duke falenderuar edhe njëherë kolegët ajo në emër të departamentit që drejton shprehu gadishmërinë për një raport vjetor më të standardizuar qoftë edhe në trajnimin e stafit.

Me qëllim përmirësimit të zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2019 - 2021, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të monitorimit janë:

- Sigurimi i një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent konsultimi gjatë fazave të raportimit, monitorimit me institucionet përgjegjëse dhe grupet e interesit.
- Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndër-institucional.
- Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të përcaktuara.
- Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit pranë Drejtorive të Financës, të institucioneve përkatëse, përpara momentit të raportimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- Lidhur me OGP, koordinim me institucionet përgjegjëse për masat në kuadër të finalizimit të Planit të Veprimit duke marrë parasysh mendimet e grupeve të interesit gjatë fazës së konsultimeve.

Më pas fjalën e morri për diskutim, z. Afrim Krasniqi, nga shoqëria civile i cili pati rezervat e tij për kërkimin e sugjerimeve mbi OGP gjatë muajit gusht, i cili është muaj pushimesh. Me tej z. Krasniqi ngriti shqetësimin lidhur me numrin e akteve të miratuara nga Ministria.

Shqetësimin të tij iu përgjigj z. Beja, i cili bëri me dije se aktet nëligjore që do dalin në zbatim të ligjeve të reja të profesioneve të lira, një pjesë është miratuar. Disa duan propozimin ose dakordësinë e dhomave. Pavarësisht kontributit të tyre të gjitha aktet janë hartuar mbi 300 faqe material. premtimin tim personal që të gjitha aktet nëligjore që do duhet të ishin përmbyllur do miratohen deri në fund të vitit. Ai siguroi pjesëmarrësit se Puna e bërë dhe që vijon çdo ditë nga stafi i ministrisë së drejtësisë, Drejtoria e kodifikimit është kolosale

Zbatimi i Programit të Punës së GMIP¹ në 2020

Gjatë vitit 2020, Komitetit Drejtues Sektorial (KDS) për Reformën në Drejtësi sipas planifikimit në kalendarin vjetor të GMIP/KDS për vitin 2020, është mbledhur/do të mbledhet për të zhvilluar

¹ Programi i Punës lidhet me veprimtaritë e planifikuara në kalendarin vjetor.

takime të tjera në kuadër të miratimit të raporteve të monitorimit. Gjithashtu do të vijojë puna për organizimin e takimeve të vogla teknike më përfaqësues të OJF, lidhur me përfundimin e planit të veprimit mbi komponentin nr. 3 “Aksesi në drejtësi” të OGP.

4. Çështjet kryesore në vijim

- Hartimi sipas standarteve të sistemit IPSIS të raporteve të monitorimit në zbatim të Strategjisë.
- Miratimi i planit të veprimit për komponentin nr.3 të OGP, në bashkëpunim të ngushtë më OJF.

Anekset

- Agjenda e takimeve të KDS/Mekanizmit Institucional
- Listëprezenca e takimeve të KDS/Mekanizmit Institucional
- Lista e dokumenteve, raporteve, etj.